

Teuta HADRI

ROLI I GRUAS SHQIPTARE NË ÇLIRIMIN E KOSOVËS

Është hera e parë që Instituti i Historisë organizon një konferencë mbi rolin e veçantë të gruas në jetësimin e shtetit të Kosovës, ku me të drejtë i jepet rëndësi kontributit të saj. Janë mbajtur dy konferenca mbi rolin e gruas në jetësimin e shtetit të Kosovës. Njëra në vitin 2010 e organizuar nga vetë gratë e lëvizjes çlirimtare, të cilat u ndihmuan edhe nga Shoqata e të Burgosurve Politikë dhe Instituti Albanologjik. Në atë Konferencë ishin prezantuar 40 kumtesa dhe 4 referate. Temat ishin me karakter social, kulturor, historik e politik, ndërsa kishin përfshirë rolin e gruas që nga viti 1945 deri më 1999. Kjo Konferencë ishte përcjellë nga 450 pjesëmarrës, kryesisht gra veprimtare dhe aktiviste të kësaj periudhe të Lëvizjes çlirimtare, por gjithashtu pati interesim edhe të pjesëmarrësve të tjerë. Materialet e kësaj konference i ka botuar Instituti Albanologjik, ndërsa, si të tilla, përgjatë viteve kanë zgjuar vëmendjen e opinionit të gjerë dhe veçmas të atij historiografik.

Konferenca u nderua nga një numër i madh personalitetesh shoqërore e shkencore, duke filluar nga Mendela i Kosovës, Adem Demaçi, pastaj kryetari i Shoqatës së të Burgosurve Politikë, Hydajet Hyseni, akademik Rexhep Qosja, drejtori i Institutit Albanologjik, prof. dr. Hysen Matoshi, si dhe profesorë të shquar nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, nga mërgata etj. Konferenca e dytë u mbajt më 2021, ndërsa u organizua nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë. Më duhet të theksoj, se Konferenca e sotme e ka rëndësinë e saj, sepse fokus të veçantë e ka kontributin e gruas gjatë periudhës nga vitet '80-të e deri në ditët e sotme. Konferenca po organizohet nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" i Prishtinës. Ju jemi vërtet mirënjohëse. Edhe unë si veprimtare e kësaj periudhe përkrah këtë temë dhe do të jap

kontributin tim, jo si transmetuese e rrëfimeve që kam dëgjuar nga të tjerët, por si dëshmitare e bashkëveprimtarëve dhe pjesëmarrëse në ngjarje faktike. Sot shfaqem edhe si protagoniste e këtyre ngjarjeve, por edhe si rrëfuese e tyre. Unë besoj fuqishëm se, për ta kuptuar rolin e gruas dhe fuqinë e zërit të saj gjatë kësaj periudhe, nuk mund ta anashkalojmë trashëgiminë tonë historike, në të cilën doli në pah trimëria e gruas shqiptare.

Trashëgimia historike e gruas shqiptare nuk ka të bëjë vetëm me të sotmen. Ajo fillon nga mbretëresha Teuta, e cila e udhëhoqi një mbretëri ilire, pastaj u përcoll brez pas brezi te Nora e Kelmendit, Tringë Smajlaj, Shote Galica, stratege e luftëtare e çetave të Azem Bejtës, Bije Vokshi, Marije Sllaku, Katarina Josipi, Gita Mjeda, Nasibe Zhuri, Lucije Lekaj, Hyrije Hana, Hyrema Dula etj. Lista vazhdon me emra të tjerë të grave të shquara atdhetare, sikundër janë: Adile Muqolli, Shahzije Gërguri, Elhame Shala, Mejreme Berisha, Eshrefe Halimi, Vahide Hoxha, Emine Rakovica e Nefize Qerimi. Ne u inspiruam nga këto gra, kauzën e të cilave e aktivizuam më 1968.

Lëvizja e gruas për shtetformim nuk u ndal këtu. Ajo vijoi edhe më fort dhe roli saj u spikat edhe më fuqishëm gjatë lëvizjes ilegale para vitit 1980 me veprimtarët, si: Haxhere Hajrizi, Ajshe Hajrizi, Hidajete Osmani, duke vazhduar me grupin e grave të organizuara në Lëvizjen Ilegale prej vitit 1978, ku bënë pjesë: Remzije Limani, Saime Isufi, Teuta Bekteshi, Teuta Hadri, Naime Maqestena, Mejreme Krasniqi, Mehrije Krasniqi, Lumnije Musa, Xhevë Lladrovci, Shemsije Elshani, Drita Kuqi, Flora Ramadani, Teuta Hamiti, Kadrije Gashi, Kimete Hasani etj. Pas Kushtetutës së vitit 1974, krahas zhvillimit kulturor, historik e intelektual, arsimimi i gruas filloi me një hap më të madh, ngaqë ajo tashmë ishte krah burrave, si në shkollimin e mesëm, të lartë e në universitet, duke marrë edhe tituj shkencorë. Edhe kultura kishte filluar të lulëzonte kudo falë prezencës më të madhe të gruas. Por kjo nuk zgjati shumë, ngase politika serbo-sllave ndaj popullit shqiptar ndryshoi rrënjësisht. Qasja ishte artificiale në raport me të drejtat e shqiptarëve të cilat ishin të gjymtuara dhe të përfshira vetëm sa për ta mashtruar opinionin ndërkombëtar. Megjithatë, në vendimmarrje dhe në punësim, shqiptarëve iu shkeleshin të drejtat në mënyrë masive. Politikat ndaj shqiptarëve ishin jo vetëm perfide, por edhe diskriminuese. Kjo bëhej edhe duke i ndarë e diskriminuar institucionet shqiptare që, posa kishin filluar lulëzimin e tyre drejt dijes e kulturës kombëtare dhe

duke i trajtuar si të pabarabarta në raport me ato të republikave të tjera. Shqiptarët nuk kishin të drejta të barabarta si popujt tjerë të ish-republikave jugosllave, ngaqë shiheshin me sy tjetër.

Kjo gjendje diskriminuuese rëndoi edhe më shumë mbi supet e gruas. Ajo, jo vetëm që diskriminohej në raport me burrat si fuqi punëtore, por ishte lënë pasdore edhe në shkollim. Në vende pune më parë pranoheshin burrat sesa gratë, duke krijuar një raport 4 me 1 për një vend pune, ndërsa kjo dukuri nuk ekzistonte te republikat e tjera. Kjo politikë e barazisë gjinore nuk zbatohet në Kosovë, ngaqë emancipimi dhe përparimi i gruas shqiptare i tmerronte politikant antishqiptare. Ishin mësuar ta shihnin gruan si amvise, të pangritur, të izoluar, të robëruar nga pushtuesi dhe vetë mentaliteti patriarkal shqiptar. Nga karakteri social, ajo gjatë viteve '80-të ishte e varfër, e papunësuar, nën barrën e mbajtjes së familjes, rritjes së fëmijëve etj. Jeta e gruas rëndohej fizikisht e shpirtërisht, duke u ngufatur edhe me numrin e madh të lindjeve, deri në 10 fëmijë, ndërsa mesatarja ishte 3-4 fëmijë. Madje, gratë ishin ato që kontribuan për rritjen e popullsisë, duke i lënë anash prioritetet e tyre profesionale.

Një kohë të gjatë gratë ishin të mbyllura brenda mureve të shtëpisë. Edhe kjo dukuri nuk ishte e pranishme te popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë. Me shkollimin, emancipimin dhe zhvillimin e gruas pushtetarët e shihnin rrezikun që u kanosej, sepse populli shqiptar në Kosovë po vetëdijesohej në të gjitha drejtimet. Ishte e qartë se së shpejti do ta kërkonte republikën e tij dhe barazinë me popujt tjerë të ish-Jugosllavisë. Shtëpia shqiptare ishte shndërruar në shkollë. Krahas mbajtjes së barrës së rëndë të punëve shtëpiake, gruaja tani gjente pak kohë dhe një hapësirë të vogël në shtëpi, ku mund të ulej dhe ta merrte librin në dorë, ashtu që ta ndriçonte mendjen nëpërmjet vetarsimit, të arsimohej krahas burrit, e madje edhe ta kalonte atë. Baballarët dhe nënat tona heroina përpiqeshin në maksimum që bijat e tyre të shkolloheshin, të bëheshin të suksesshme dhe të nderoheshin nga shoqëria. Nuk ndryshoi vetëm shoqëria, sepse ndryshuan, në rend të parë, familja dhe shtëpia shqiptare. Ato u shndërruan në vende ku diskutohej për kulturën, historinë, sportin, politikën. Të gjitha këto aktivitete tashmë kishin hyrë në pjesën dërrmuese të familjeve shqiptare. Një lumturi e paparë, por që nuk pati jetë të gjatë. Shteti i Serbisë, si pushtues që ishte, diskriminonte në vazhdimësi shqiptarët. Ai bënte plane ogurzeza që ta ndalonte këtë hov të zhvillimit të shqiptarëve në Kosovë. Çdo barrë, që rëndonte mbi supet e popullit,

binte edhe mbi gruan shqiptare.

Duke e parë këtë diskriminim ndaj popullit dhe bijve të vet, gruaja iu bashkua zërit kundërshtues të veprimit kundër diskriminimit të popullit të saj dhe në mbështetje të luftës për liri. Krahas zhvillimit intelektual u inkuadruan në Lëvizjet për Çlirim Kombëtar dhe filluan veprimtarinë e tyre kundër pushtuesit serbo-sllavë, duke hyrë thellë në jetën politike, që nga organizimi i celulave e grupeve e deri tek organizatat që vepronin për lirinë e Kosovës. Ato, me veprimet e tyre, formuan njeriun e ri, gruan e re në Kosovë, gruan që do ta bënte luftën e saj për lirinë. Këto gra ishin bija të zgjedhura nga të gjitha shtresat e popullit, nga familje të rëndomta e deri te shtresat e larta intelektuale e arsimore. Ishin gra me gjeneza familjare patriotike nga baballarët dhe gjyshërit e tyre. Ato, krahas burrave, ishin anëtare të celulave të para që luftonin për çlirim kombëtar. Ato bënë veprimtari, agjitacion, propagandë të të gjitha shtresat e popullit, për ta vetëdijësuar atë, për një bashkim kundër robërisë dhe për ta përgatitur në luftë për liri. Gruaja, jo vetëm që ishte anëtare e celulave, por ajo punoi për ta zgjeruar veprimtarinë e Lëvizjes Ilegale, organizoi vetë celula, grupe dhe hyri si anëtare e lartë e organizatës vepruese.

Në Kosovë, në vitet e '80-ta, vepronin disa grupe ilegale, si: “Bashkimi”, “Fronti i Kuq”, “Lajmëtari i Lirisë” dhe OMLK-ja si organizata më e madhe e kohës. Kudo në këto organizime kishte prezencë të gruas si anëtare dhe si drejtuese. Hyrja e saj në organizim politik i dha forcë dhe unitet lëvizjes. Gratë ishin të fuqishme e të pathyera. Nuk ishte tani një zë gruaje, apo të dy a tri grave, por një grup i madh i tyre që vepronin në lëvizjen ilegale për çlirim. Pjesëmarrja e grave ishte masive. Forca e fuqia e gruas u dëshmuar edhe gjatë demonstratave të vitit 1981. Gratë ishin jo vetëm si veprimtare, por edhe organizuese. Ishte një fuqi uniteti që e krijonte pjesëmarrja e saj bashkë me burrat. Para vitit 1981 në Kosovë ishte bërë një demonstratë më 1978. Protesta ishte organizuar nga studentët e Fakultetit të Mjekësisë. Mbi 500 studentë u organizuan me kërkesën për t'i larguar profesorët që vinin nga Serbia dhe që ata të zëvendësoheshin me kuadro nga Shqipëria. Kjo shërbeu si maskë për të demonstruar, sepse, në të vërtetë, kjo demonstratë bëhej për ta rikujtuar 10-vjetorin e demonstratave të vitit 1968. Studentë dhe studente marshuan nga Fakulteti i Mjekësisë deri në Rektorat me kërkesat e tyre. Për kërkesat e tyre para rektorit folën Hasan Bekteshi, Teuta Bekteshi dhe Arsim Braha. Por edhe pushtetarët u treguan

perfidë e diplomatë.

Në mbrojtje të kërkesave të tyre doli Mahmut Bakalli, i cili kishte deklaruar: “*Asnjë thua i një studenti të mjekësisë, që janë “ajka e popullit”, “nuk dua të preket”!* Udhëheqja i shpërndau me plotësimin e kërkesave të tyre, por nuk e lanë pa e arrestuar folësin e parë, Hasan Bekteshin, i cili u dënua me dy vjet burg, ndërsa të tjerët mbetën në liri! Lëvizja ilegale me anëtarët e saj kishte arritur që mes anëtarëve të saj, si: Teuta Bekteshi, Sami Pireva, Teuta Hadri, Mejreme Krasniqi, Remzije Maxhuni, Remzije Rafuna, Memnune Ushtelenca, Binaze Krasniqi, Zybaje Rraci, Deli Haxhocaj, Ukshin Ismaili, Ramadan Sopi, Hydajet Paqarizi, Aziz Pollozhani, Sali Krasniqi, e shumë gra dhe burra të tjerë, të jenë forcë e zë uniteti si protestues. Veprimtaria e gruas u bë edhe më e fuqishme, kur ajo e pa se roli i saj është forcë veprimi dhe uniteti mes burrave e grave; ajo e ngriti grushtin edhe më fort kundër pushtuesit në luftë për realizimin e aspiratave liridashëse. Nga viti 1978 deri më 1981 gruaja punoi, pa u ndalur asnjë çast dhe shfrytëzoi çdo formë të rezistencës dhe veprimit, qoftë në familje, qoftë në institucione; shfrytëzoi çdo hapësirë veprimi për të organizuar një shpërthim më të madh dhe të fuqishëm, siç ishin demonstratat e 11 marsit, 26 marsit dhe të 1 prilli të vitit 1981.

Demonstrata e 11 marsit 1981 ishte si një shpërthim i zërit dhe fuqisë popullore, një vullkan i paparë. Shumëkush atëbotë (madje edhe sot) i quajti si demonstrata të rastësishme. Por jo, zotërinj “intelektualë”! Ky term e kjo ide ishte diskursi i armikut. Ishte politikë e pushtetit që përdorej me qëllim të shkatërrimit të grushtit protestues dhe çdo gjëje revolucionare! Lind pyetja, nëse ishin të rastësishme, pse nga policia speciale u përdor aq dhunë ndaj rinisë studentore, veçmas ndaj vajzave studente, duke i goditur në bark me tërë forcë e duke iu bërë: “*Nikad neqesh da rodish albancal!?* (Asnjëherë nuk do të lindësh shqiptar). Dhuna e tërbuar u përdor për t’i shuar ato dhe për ta tmerruar popullin, me qëllim që të shkatërrojnë çdo rezistencë revolucionare! Pushteti kudo i kishte futur agjentët e vet serbë, në konvikte ku kujdestaronin edhe natën fshehurazi, për të hetuar çdo lëvizje të veprimtarëve. Ata kishin hetuar një lëvizje që po vepronte, por kush ishin?! Para 11 marsit 1981, vajzat studentore, veprimtare të lëvizjes ilegale, organizuan shkrimin e parullave në konvikte 1 dhe 2. Ato u shkruan me “buzëkuq” në muret e këtyre konvikteve. Ndarja e grupeve ishte kështu: në konviktin nr.1 parullat u shkruan nga Remzije Limani dhe në konviktin 2 ato u shkruan Teuta Hadri,

Lumnije Këpuska dhe Xhevë Lladrovci. Pushteti serb dhe qeveria i quajtën “parulla armiqësore”. Ndonëse hetoheshin veprimtarët, ato nuk u zbuluan. Qëllimi i këtyre parullave ishte të nxisin dhe të ngrinin sa më shumë vetëdijen e studentëve për të vepruar më shpejt për realizimin e aspiratës për liri. Kjo bëhej, sepse kishte filluar një lëvizje e madhe patriotike në mesin e studentëve. Kudo, pra edhe në konviktet e djemve, vepronte lëvizja ilegale me anëtarët e saj. Ajo kishte filluar me grindjen e studentëve shqiptarë me studentët serbë për shikimin e Televizionit Shqiptar, por gjithashtu studentët e organizuar, në dhomat e tyre, lëshonin muzikë me këngë patriotike, duke e elektrizuar edhe më shumë situatën. As agjenturat nuk flinin.

Ato vepronin prapa shpine me agentët e tyre për zbulim, që njihen dhe dihen, si i famshmi Muja i Pejës, B. H., B. R., Z. M., I .S. e shumë të tjerë. Gjatë këtyre aksioneve që bëheshin, gruaja zbulonte kapacitete të reja patriotike mes studentëve të gatshëm për veprim. Ajo ishte shpërndarëse e literaturës ilegale, të siguruar kryesisht nga drejtuesit e grupeve dhe organizatave, si Hasan Mala, i cili ishte furnizues kyç i saj, pastaj Nuhi Berisha, Fahredin Hoxha, i dënuar i burgut famëkeq të “Goli Otokut”. Kur këto rrugë bllokoheshin, shfrytëzoheshin edhe rrugë të tjera. Vlen të përmendet edhe veprimi i studenteve, që organizonin udhëtimin në Shqipëri, ku furnizoheshin me literaturë, ndërsa fshehurazi nga kufiri i dërgonin në adresa të vëllezërve të shoqeve në Zvicër, prej nga silleshin në Kosovë, përmes grave. Kujtoj lidhur me këtë Zubaje Racin dhe Binaze Krasniqin. Prandaj, qëllimi kryesor i demonstratës ishte bashkimi i të gjitha celulave, grupeve dhe të gjithë patriotëve, në një trup të unifikuar, në një organizatë më të madhe, siç ishte OMLK-ja, për veprim të fuqishëm dhe me një zë. Më vonë, pas dy vjetësh, u bë bashkimi i krerëve të tyre, Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës. Pjesëmarrja në demonstrata ishin testimi më i lartë i veprimtarëve dhe anëtarëve të të gjitha grupeve ilegale. Aty shihej devotshmëria për ta çuar rrugën e tyre drejt fitores, ku ata do të ballafaqohen me një të ardhme më të vështirë, e që kjo dihej se do të përfundonte me burgosje, dhunë, tortura dhe vrasje.

Si vepronin celulat dhe grupet

Celulat dhe grupet vepronin në bazë të planit të OMLK-së. Ato kishin edhe një rregullore të brendshme veprimi. Mbanin mbledhje të rregullta, të cilat organizoheshin çdo tri javë, por varësisht nga rendi i ditës dhe aktiviteti ato organizoheshin edhe më shpesh. Çdo celulë siguronte bazën dhe fondin e vet. Anëtarët e celulës kishin pseudonimet e tyre, që të mos identifikoheshin nga UDB-ja, e cila ishte prore në gjurmë të tyre. Pra, vepronin me një konspiracion të thellë. Cili ishte qëllimi i veprimit? Qëllimi ishte zgjerimi i radhëve me anëtarë të rinj dhe të përbetuar me jetë deri në vdekje për çështjen kombëtare. Këta anëtarë i gjenin kudo te familjet patriotike në Kosovë. Gjatë kësaj kohe në Kosovë, nga viti 1978 e deri më 1981, vetëm nga grupi ynë, nga Hasan Mala, Remzije Limani dhe Teuta Bekteshi, u formuan shumë celula e grupe të cilat zgjeroheshin në çdo qytet dhe fshat të Kosovës.

Celulat vepronin zakonisht në treshe, katërshe dhe dyshe. Një rëndësi e madhe i kushtohej ngritjes së vetëdijes, edukimit dhe kalitjes së tyre për të vepruar e për të bërë agjitacion, shpërndarjes së literaturës, shkrimit të parullave me veprim propagandues, informimit të saktë, formimit të bazave në familjet e qytetarëve dhe përgatitjes së tyre heroike për një demonstratë gjithëpopullore. Përbërja ishte nga këta anëtarë: në Prishtinë vepronte Celula 1: Hasan Mala, me nofkën “Halim Xhelo”, i cili ishte drejtues i grupit; Remzije Limani - “Ganimete Terbeshi”; Teuta Bekteshi me nofkën “Bule Naipi” dhe Teuta Hadri me nofkën “Shote Galica”. Celula 2 i kishte këta anëtarë: Teuta Bekteshi, me nofkën “Flora”; Sami Pireva i njohur si “Besniku”, Teutë Hadri. Celula 3: Teuta Bekteshi, Bajram Bahtiri, tani dëshmor. Celula 4: Teuta Hadri si “Lulja”, pastaj Teuta Hamiti ishte “Shqipja”; Kimete Hasani ishte “Ganja”. Celula 5: Teuta Hadri si “Lulja”, Naime Maqestena si “Fato”; Bujar Zeneli kishte nofkën “Sokoli”. Celula 6: Lumnije Musa me Xhevë Lladrovci dhe Xhanije Hulajn. Celula 7: Nuhi Berisha me grupin e tij, Shukrije Gashi. Celula 8: Binaze Krasniqi, Xhevë Lladrovci e Sanije Loshi. Celula 9: Xhevë Lladrovi, Mejreme Krasniqi, me motrën Mehrije Krasniqi (ajo u arrestua me grupin, Shaban Shalën e Adem Kastratin dhe u mbajt tri javë në Burgun e Mitrovicës). Më duhet të bëj një rikujtesë! Mihrija ishte torturuar aq shumë nga inspektorja Zyhra Kastrati, aq sa në një moment ajo arriti t’ia marrë inspektorit, me emrin Nevruz, shkopin e

gomës dhe ta rrihte inspektoren Zyrajen. Mirëpo, pastaj ajo u sulmua, nga grupi inspektorëve dhe u rrah aq shumë me qëllimin që ta zbulonin grupin e saj. Kjo i kushtoi me tortura të mëdha aq sa, edhe pas daljes nga burgu, trupi i saj i njomë rënkonte nga hematomat. Bashkë me atë ishin arrestuar edhe grupi i Memnune Ushtelencës me motrat e saj, Gonxhen dhe Shqipen, e cila ishte nxënëse në shkollën e mesme dhe vepronte në organizimin e vajzave në shkollat e mesme. Por, në mungesë të fakteve ishin liruar nga organet e UDB-së.

Në përvjetorin e demonstratave të vitit '81, Mejremja kishte vepruar në shpërndarjen e trakteve me Adem Krasniqin, Xhevat Zekën dhe Qamil Qadrakun. Ajo kishte rrezikuar edhe gjatë daljes me ambasadorin e Shqipërisë, Sokrat Plaka, kur ajo ndiqet nga forcat e agjentëve, por u shpëton duke mos u rënë në duar. Dy shoqet e saja shoqëruese ishin arrestuar, njëra nga Otrozubi i Rahovecit, së cilës ia arrestuan babanë dhe vëllanë, me qëllim që ta kuptonin se kush ishte ajo vajza. Por ata kishin rezistuar dhe nuk kishin treguar për Mejremen. Ajo u përjashtua nga konvikti për dyshime në veprimtari dhe u mbajt në bisedë informative që kishte zgjatur 5 orë. Megjithatë, Mejremja nuk kishte zbuluar asgjë nga ana e saj.

Në Prishtinë vepronin edhe grupe rezervë të veprimtarëve që ende nuk e kishin bërë betimin për të hyrë grup. Këta ishin Shqiponja Hamiti, Suzana Agaj, motrat Pllashniku, Sadije Shabani. Në Fakultetin e Mjekësisë një mbështetje të madhe e kishim edhe nga asistentë veprimtarë, si: Xhevat Morina, Rexhep Hoxha, prof. Irfan Spahiu, Aziz Pollozhani, prof. Muharrem Kutllovci, Hysni Daka, i burgosuri Avdi Avdiu (dermatolog). Në Gjakovë vepronin Teuta Hadri, Fahredin Hoxha, me nofkën "Nini", i dënuar 3 herë në burgjet famëkeqe të Goli Otokut, i cili ishte nderi i grupeve tona të Gjakovës. Vepronin Lumnije Musa e Sylejmon Musa "Abedini", Fuat Haxibeqiri me nofkën "Besniku", Teki Dula, Nexhat Rexha, Hyda Dobruna, Lemane Dobruna, Feim Komoni. Pastaj ishin veprimtarë, të cilët ende nuk e kishin dhënë betimin, si: Ilirjana Nura, Sakibe Doli, Diamant Abrashi, Pleurat Hadri, Xhemile Hoti, Nora Zherka, Ilirjana Bytyqi, si dhe grupi i studentëve, si: Faton Deva, Luan Nushi, Gëzim Sada, Hajdar Soba, Arsim Hoxha. Në Deçan vepronte grupi i Drita Kuqit, Hasan Ukëhaxhajt. Në Rahovec vepronin Mejreme Krasniqi me grupin e djemve dhe Mihrije Krasniqi me grupin e vet. Në Suharekë vepronin Shemsie Elshani, Kada Berisha e Zyrafete Kryeziu me grupin e vet, e cila ishte në veprim edhe me Nuhi Berishën dhe

motrat Qefsere e Shyhrete Malaj nga Gjilani. Në Malishevë vepronte Mira Kuqi me motrën Minije Kuqi, Gani Krasniqi me grupin e studenteve Zade e Xhyle Kelmendin dhe Xhule Berishën.

Në Drenicë vepronin Xhevë Krasniqi-Lladrovci me grupin e vet, Xhyle Hyseni dhe Sevdije Krasniqi. Në Gjilan vepronin Ilmi Ramadani, me nofkën “Tomori”, Hasan Mala “Veliu”, Teuta Hadri, Saime Isufi “Bulja”, Remzije Limani, Hanife Mala, Saime Limani, Rexhije Mala, Qefsere Malaj, Shyhrete Malaj, Xhyzide Osmani, Suzana Basha, Sabri Sherifi, Sadri Sherifi, Sadbere Sherifi, Abdullah Tahiri, Bejtullah Tahiri etj. Për shembull, Hasan Mala, Ilmi Ramadani ishin në grup me Teuta Hadrin. Në Ferizaj vepronin: Nazife Xhemajli, Hafide Topalli, Nazife Xhemajli, Shadije Xhemajli, Minire Ramadani, Florije Ramadani, Elmaze Grainca, Shahdije Lohaj dhe grupi i vajzave me Lumnije Morinën. Në Shtime vepronte grupi i Kadrie Gashit. Në Mitrovicë ishin Remzije Maxhuni, Ajshe Osmani (ajo u burgos me Hatixhe Hysenin nga Prizreni). Grupi i grave ishte shtyllë e rezistencës dhe veprimit, ku ato arritën nga aktiviteti i tyre i besuar të lidhen edhe me grupin bazë, komitetin e organizatës OMLK, përmes Hasan Malës me Ilmi Ramadanin (Tomorin) dhe Hydajet Hysenin (Agimin), Mehmet Hajrizin, Saime Isufin, Nuhi Berishën. Një aksion shumë i vështirë ishte takimi i Rexhep Malës, i sapodalë nga burgu dhe lidhja me Nuhi Berishën, i kaluar në ilegalitet dhe i kërkuar nga UDB-ja. Takimi i tyre u organizua nga Teuta Hadri më 14 qershor 1983.

Aksione u bënë edhe në rajonin e Gjilanit në kodrën e Kamenicës, ku u fshinë shkronjat e emrit të renegatit “TITO” që mbulonin disa metra kodrën me gurë mermeri të bardhë. Ky aksion u bë nga grupi Hasan Mala, Remzije Limani dhe Teuta Hadri. Në Prishtinë pothuajse në të gjitha shkollat vepronin anëtarë tanë, të cilët në xhepat e tyre mbanin nga një laps fllamaster për të shkruar, kur t’ju jepet rasti, qoftë edhe vetëm dy shkronja K. R. (Kosova Republikë). Aksioni me parulla, me ngjyrë të kuqe, u zhvillua edhe në shkollën “Josip Broz Tito” (“Ismail Qemali”) 3 herë, ku u shkruan parullat “Poshtë Tito dhe titoizmi”, “Rroftë Shqipëria”, sikundër edhe në shkollat “Emin Duraku”, “Meto Bajraktari” etj. Një parullë e madhe me tekstin “Kosova Republikë”, në gjatësi deri 100 m dhe madhësi shkronjash prej 1 m, me ngjyrë të kuqe u shkrua në asfaltin e rrugës pas konviktit 5 ndërmjet dy udhëkryqeve. Në kohën kur UDB-ja mendonte se shkatërroi tërë organizatën, më 8 mars, u bë shpërndarja

e 300 trakteve në lagjen e Muhaxhirëve, ndërsa ky aksion u krye nga Teuta Bekteshi dhe Sami Pireva. Ndërsa, në Bregun e Diellit 1, shpërndarja u bë nga Teuta Hadri, kurse traktet u shtypën në shtëpinë e Suzana Agës.

Në Gjakovë, më 27 shtator 1982, u bë shpërndarja e trakteve që ishin sjellë nga “Malazezi”, që ishte pseudonimi i Nazmi Hoxhës. Aksioni u krye në lagjen e Kusarëve, rrugën “Tefik Çanga” dhe rrugën “Skënderbeu”, nga Pleurat Hadri e Teuta Hadri dhe në Çabrat nga Nuhi Berisha “Naimi”, sot hero, i cili pas vitit 1981 kishte krijuar lidhje, i drejtuar nga Komiteti i organizatës nga Hasan Mala, i larguar në Zvicër me Teuta Hadrin “Shotën” për organizimin dhe riaktivizimin e anëtarëve të tjerë. Një aksion i vështirë ishte shkrimi i parullave në murin e ambulancës “Isa Grezda”, me pamje nga pazari, afër 100 metra, që u krye nga Lumnije Musa, Teuta Hadri dhe Sylejman Musa.

Me këto aksione kalitëshin dhe forcoheshin anëtarët e rinj për veprim, për të ardhmen më të madhe, siç ishin demonstratat 11 marsit të vitit 1981. Ato shpërthyen në Mensën e Studentëve, po ashtu nga një grua “cimere” dhome me Xhevë Lladrovcin, Bahrije Kastrati, e cila e përplasi një tabak dhe revolta shpërtheu edhe më shumë se sa mendohej, sidomos në momentin kur erdhën agjentët e UDB-së ajo u elektrizua më shumë duke u përfshirë të gjithë studentët dhe studentet. Ajo nga mensa u zgjerua dhe marshoi në rrugë para mensës. Studentëve dhe studenteve nga kjo revoltë iu bashkuan studentë të të gjitha konvikteve, turma-turma. Nuk kishte zë më kumbues e zë më kushtrimuar se zëri i studenteve që thërrisnin “bashkohuni vëllezër të gjithë me ne” dhe me duart e tyre të lidhura me studentët kishin krijuar kordonin e mbrojtjes që agjentët të mos i rrëmbenin ata studentë që u kishin rënë në sy. Jo nuk i lëshojmë vëllezërit tanë! Parullat ishin: “Duam Bukë”, “Kushte më të mira”, pastaj u politizuan kërkesat me parullat: “Duam Bashkim”, “Vëllezër bashkohuni me ne” dhe “Kosova Republikë”. Demonstrata në fillim u udhëhoq nga Deli Haxhocaj, veprimtar dhe shoku ynë, pastaj atë e drejtoi Ali Lajçi. Protesta ishte shpërndarë me dhunë e gjak. U plagos shoku ynë Ukshin Ismaili, i cili ishte student i Fakultetit të Mjekësisë. Më 26 mars të vitit 1981 vazhduan protestat. Qëllimi ishte të mos ndaleshin, duke shfrytëzuar dhunën që ushtroi policia ndaj studentëve, lëvizja ilegale e përdori situatën dhe i vazhdoi ato. Vajzat e lëvizjes ishin aktive e trimëresha, prandaj demonstrata u quajt “Pranvera e

lulëkuqeve”. Nuk harrohet Trëndelina Labinishti nga Ladorishta e Strugës, studentja që u mbështoll me flamurin shqiptar në demonstratën e 26 marsit 1981. Trëndelina nuk e lëshonte flamurin për të rënë në dorë të policisë speciale. Rreth 6 persona e sulmonin për t’ia marrë flamurin. Ajo bërtiste “Vëllezër merreni flamurin, mos e lëshoni, ecni përpara”.

Më 27 mars të vitit 1981 ishte realizuar takimi ndërmjet “Agimit”, ishte nofka e Hydajet Hysenit, i cili, siç u kuptua më vonë, kishte ardhur me Ilmi Ramadanin, për t’u takuar me Teuta Hadrin e për t’i informuar më shumë për demonstratën e 11 marsit 1981, si quante “Agimi”, vajzat lulëkuqe. Takimi ishte organizuar mes Ilmiut dhe “Agimit”. Nga Prishtina, me një makinë, udhëtuam në fushat e lagjes “Gavran” të Gjilanit, për të pasur më shumë siguri të “Agimit”, i cili ishte nga ky qytet. Qëllimi i takimit ishte që të mbeteshim në kontakt, unë me grupin tim të nxënësve të shkollave dhe studentëve veprimtarë për një organizim brenda ditëve të ardhshme, siç thoshte “Agimi”, organizim gjithëpopullor, burra gra, studentë, nxënës, punëtorë e fshatarë që do të ngrinin grushtin e fortë e ta shkatërronin këtë Jugosllavi të Titos që po vriste e po burgoste shokët, rininë tonë. Ta largonim nga këto troje njëherë e përgjithmonë.

Kujtoj se, 1 prilli 1981 ndodhi vërtet si thoshte “Agimi”. Kishte pjesëmarrje masive, burra, gra, i gjithë populli u ngrit në këmbë për të drejta e liri. Kjo demonstratë u drejtua nga shoku “Agim”. Në demonstratë e kuptova nga Remzije Limani, veprimtarja e celulës sonë, se ishte fjala për gazetarin Hydajet Hyseni, i cili hipi në lis dhe e mbajti fjalimin. Pas tij foli edhe anëtarja e celulës Remzije Limani. Nuk ka forcë më të madhe se vajza kur bashkohet dhe e ngre grushtin për liri. Protestat u shuan me forcë e dhunë policore të shtetit. Ato vazhduan edhe më masive. I gjithë populli ishte ngritur dhe u ishte bashkuar demonstruesve. Më 2 prill u plagos 13-vjeçarja Besa Ahmeti, e cila me sa forcë që kishte bërtiste: “Lërmëni mua, nuk kam gjë, shikoni të tjerët, unë pak jam plagosur”. Por në fakt kur më thirrën si mjeke ta ndihmojmë pamë se ishte plagosur rënd në shtyllën e kurrizit. Këto ishin vajzat trimëresha, që u jepnin forcë e moral edhe burrave. Ato u rrahën, u lënduan, u sakatuan, nga dhuna barbare policore, u arrestuan dhe u burgosën nga forcat policore. Prandaj, sakrifica dhe gjaku i bijave tona i dha një vend të nderuar gruas në shoqërinë tonë, i dha një besim të plotë se ajo tashmë ishte bërë një faktor i proceseve politike e historike. Ato nuk i gjunjézuan as dhuna,

as tortura më çnjerëzore që u përdorën në burgje ndaj tyre, duke qëndruar të pamposhtura. Burgjet ishin mbushur me vajza të reja, nxënëse, studente e nëna fëmijësh, të cilat ishin pjesë e grupeve. Ato, vetëm pse kërkonin liri, arrestoheshin çdo ditë, torturoheshin nga dora e agjentëve tradhtarë të shitur për një pagë të pushtuesi. Ato qëndronin të pamposhtura ndaj torturave mizore.

Burgu i Mitrovicës ishte mbushur të dënuara nga 1 muaj, 6 muaj e deri 13 vjet, si Ajshe Gjonbalaj. Ato ishin nga moshën 16-vjeçare e deri në 65-vjeçare. Burgjet i shndërrojnë në shkollë, edukim, mësim, shkrim e këndim, ku nga këngët e tyre ushtonte burgu. Por dihet kjo kushtonte me dajak e dhunë e torturë. Brenda këtyre mureve të burgut u bë një besëlidhje që, kur të dalin nga burgu, të vazhdojnë aksionin për “Pajtimin e gjaqeve”. Këto gra, si: Hava Shala, Myrvete Dreshaj, Zyrafete Muriqi, Hidajete Kelmendi, Akile Dedinca, Zoge Shala, Hafide Topalli etj., pas daljes nga burgu, filluan aksionin e shenjtë të “Pajtimin të gjaqeve”. Pjekuria e tyre politike, idealet e tyre, të forta dhe qëndresa e tyre heroike në burgje arriti t’i bindte edhe shokët e tjerë të burgosur, si Adem Grabovcin, Ethem Çekun, Musa Limanin, si dhe profesorët si Anton Çetta, Rexhep Qosja, Mujë Rugova, Zekerja Cana.

Lufta për liri nuk u ndal, ajo vazhdoi me shumë protesta. Pushteti bëri dhunë, arrestoi, burgosi vazhdimisht djem e vajza. Helmoi mbi 4 000 fëmijë, vajza e djem të rinj duke sjellë terror, ndaj demonstruesve, si dhe ndaj civilëve. Dhunë ushtrohej edhe ndaj gruas. Edhe brenda mureve të shtëpisë në Deçan, si Violetë Dervishaj, nënë e dy fëmijëve, Misrete Shala në Gjilan, u keqtrajtoi Sabrije Rustaj dhe Samile Pupovci, fotografitë e të cilave në KMDLNJ përmbajnë foto më makabre, dëshmi të dhunës serbe, ndaj gruas shqiptare. Më 1 shkurt 1990 në protestat për arsimin shqip, dora vrastare e policisë vrau të miturën 17-vjeçare Ylfete Humolli nga Lupçi. Kjo kushtetutë e tankeve rezultoi me nxjerrjen e 350 000 mijë nxënësve dhe studentëve nga objektet shkollore. Kjo ndodhi pikërisht në kohën kur analfabetizmi në Kosovë kishte rënë në 17,6%. U larguan nga puna mbi 22 000 punëtorë. Barra rëndonte mbi gruan, se burrat dilnin jashtë shtetit për punë, kurse gruaja mbetej jashtë punës, në shtëpi. Por ajo nuk u lëkund në asnjë moment në luftën e saj drejt lirisë. Më 8 mars u bënë protesta e gruas në Pallatin e Rinisë për t’i ndihmuar e ftuar studentët e larguar me dhunë nga konviktet për strehim në shtëpitë e tyre. Dhjetëra e dhjetëra protesta u mbajtën, që nga 1981 e deri më

1998, ku në mënyrë masive merrte pjesë edhe gruaja. Kjo qëndresë e nënave, motrave dhe bijave tona ishte rezultat i edukimit dhe i frymëzimit të qëndresës të popullit tonë gjatë periudhës së mbi një shekulli përpjekje për liri. Serbia, si plagë të vetën shpirtërore, kishte urrejtjen e familjes shqiptare. Sulmet filluan jo ndaj një personi, por tani shënjestër ishte familja dhe bërthama e saj e edukimit patriotik.

Më 5, 6 e deri më 9 mars 1998 një dorë e zezë e bëri një masakër të tmerrshme mbi familjen Jashari. Forcat paramilitare policore e ushtarake kishin masakruar 53 veta, fëmijë, gra e burra nga mosha 5 vjeç e deri në 74 vjeç. Sakrifica e familjes Jashari është shembull frymëzimi i gjithë brezave. Martirizimi dhe gjaku i derdhur për lirinë e Kosovës ngriti një popull në këmbë, ku qindra djem e vajza u organizuan duke hyrë në radhët e UÇK-së.

Këto që u thanë janë dëshmi se gruaja, që nga nisma e përpjekjeve atdhetare, dha betimin për luftë çlirimtare, duke filluar nga krijimi i celulave të para, grupeve, organizatave e deri në pjesëmarrjen e saj në radhët e UÇK-së, kudo dhe kurdo vepronte e luftonte krah burrave. Rasti i Xhevë Lladrovcit, e cila luftoi krah për krah Fehmi Lladrovcit dhe bashkëluftëtarëve të tjerë, duke rënë në altarin e lirisë dhe duke u bërë njëra ndër personalitetet më të nderuara kombëtare, është një dëshmi madhore në këtë pikëpamje.